



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Infermieristikës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për **1 (një)** pozicion pune, personel akademik, me kohë të pjesshme, të kategorisë *asistent lektor*, deri në përfundim të vitit akademik 2021 - 2022.

Kriteret e kandidatit të kategorisë **1 (një)** *asistent lektor* janë si më poshtë:

Kandidati duhet të zotërojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

- Të zotërojë diplomë universitare në fushën e mjekësisë së përgjithshme. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
- Të ketë përfunduar studimet Master i shkencave ose ekuivalente me të, me notë mesatare mbi 8.
- Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
- Të jetë pjesëmarrëse në aktivitete shkencore brenda e jashtë vendit në fushën e mjekësisë.
- Të njohë mirë dhe të ketë përvojë punë si mjek me moshën e tretë.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.
- Të ketë të paktën 2 (dy) vite pune përvojë si mjek.
- Të ketë rekomandime dhe referenca nga punëdhënës të mëparshëm.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**23.02.2022– 04.03.2022**) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriteve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njësuar me origjinalin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (23.02.2022– 04.03.2022) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Aplikim për pozicionin e punës:
Asistent lektor – Departamenti i Infermieristikës
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (04.03.2022– 15.03.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

Shënim: *Formularët për plotësim gjenden në adresën:*

www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion